



Kuvendi i Komunës Klinë

01 Nr prot. 06-18355/2024

Datë: 05.06/2024

Duke u mbështetur në Nenin 12 paragrafi 12.2 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 shkronja c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe Nenin 40 paragrafi 40.2 nën pikën 3) të Statutit të Komunës së Klinës. Nenit 30 të Ligjit Nr. 03/L-048, Nenin 2,3 dhe 4 të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049. Ligjit Nr. 08/L-260 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2023. Me kërkesën e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim si dhe me rekomandimin e KPF-së datës: 20.05.2024, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e V-të të rregullt për vitin 2024, të mbajtur me datën: 30.05.2024 mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Drejtorisë për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim për ri-alokim të mjeteve buxhetore në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi -300), fondi burimor 10, Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 21, Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 22.
2. **Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300) fondi burimor 10.**
 - 2.1 Brenda kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale, fondi 10, në kuadër të programit **Planifikimi Urban dhe Mjedisi (660)**, nen-programi **Planifikimi Urban dhe Inspeksioni (66395)**, kodi funksional **(0620)**
 - 2.2 Nga projekti “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Siqevë-Ujmirë-Shtaricë” (kodi 54294), shuma **5,996.00 €**;
 - 2.3 Nga projekti “Ndërtimi i shtratit te lumit Drini i Bardhe ne Klinë, Volljak” (kodi 54334), shuma **7,495.00 €**.
 - 2.4 Nga projekti “Ndërtimi i infrastrukturës nëntokësore dhe mbitokësore Videjë-Polce-Paskalicë-Jagodë-Krushevë e Madhe” (kodi 54285), shuma **9,400.00 €**
 - 2.5 Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore ne Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma **22,891.00 €**
Arsyetim: Ri-alokimi i mjeteve brenda programit bëhet për përfundimin e punëve sipas kontratave.

3. Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 21

3.1 Nga projekti “Ndërtimi i rrjetit të ujës-jellës në Lagjen Arberia, Tigvesh, të Sheshit Nena Tereze, Dollc-Dresnik, Grabanice, Gremnik, Drenoc” (kodi 54332), shuma 4,497.00 €

3.2 Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore në Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma 4,497.00 €, **Arsyetim: Ri-alokimi i mjeteve brenda programit bëhet për përfundimin e punëve sipas kontratave.**

4. Ri-alokim i mjeteve në kuadër të kategorisë ekonomike Shpenzimet Kapitale (kodi 300) , fondi burimor 22

4.1 Nga projekti “Ndërtimi i shtigjëve të ecjës dhe infrastruktura rrugore në Gryken e Jarinës - Pogradje” (kodi 52443), shuma 15,276.50 €

4.2 Nga projekti “Asfaltimi i rrugës Afrim Haliti në Jashanicë” (kodi 52442), shuma 2,849.51 €

4.3 Nga projekti “Ndërtimi i parkut industrial për Klinë” (kodi 52447), shuma 30,000.00 €

4.4 Nga projekti “Ndërtimi me gure i sheshit "Muje Krasniqi" në Kline” (kodi 54004), shuma 1,250.80 €

4.5 Në projektin “Ndërtimi i segmenteve të rrugës "Mal Bashota", "Prek Prendi", Dositej Obradoviq, Bekim Fehmiu dhe infrastrukturës nëntokësore në Kline-Dersnik-Dollc” (kodi 54280), shuma 49,376.81 €.

Arsyetim: Ri-alokimi i mjeteve brenda programit bëhet për përfundimin e punëve sipas kontratave.

5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.

6. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga kuvendi i komunës, sipas rregullores (QRK) Nr.06/2021 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave dhe pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Me këtë vendim njoftohen:

- **MAPL;**
- **Kryetari i Komunës;**
- **Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;**
- **Zyra për Informim;**
- **Arkivi;**



**Kryesues i Kuvendit
Fadil Gashi**